

## **Klasifikimi i strukturave akomoduese me 4 apo 5 yje që janë mbajtes të një marke tregtare të rregjistruar dhe të njohur ndërkombëtarisht “brand name”**

**\*Për përfitimin e këtij shërbimi aplikimi kryhet pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.**

Klasifikimi i strukturave akomoduese me 4 apo 5 yje që janë mbajtes të një marke tregtare të rregjistruar dhe të njohur ndërkombëtarisht “brand name”, është një proces vlerësimi që i nënshtrohen të gjitha subjektet që ushtrojnë veprimtari si strukturë akomoduese, në territorin e Shqipërisë. Kushtet, kriteret, afatet, tarifat dhe procedura përcaktohen në Urdhrin i Ministrit nr.243 datë 09.07.2019 “Për miratimin e rregullores mbi procedurën e klasifikimit të strukturave akomoduese”.

Ky proces përfshin klasifikimin e strukturave akomoduese në:

- “Hotel” katër yje
- “Hotel” pesë yje;
- “Resort” katër yje
- “Resort” pesë yje;

**Sipërmarrësi për tu bërë pjesë e procesit të klasifikimit duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:**

a) Të ketë investuar në ndërtimin e një strukture akomoduese sipas kriterëve të strukturave akomoduese me 4 dhe 5 yje të përcaktuara në VKM nr. 730, datë 20.10.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifat, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave akomoduese”, i ndryshuar.

b) Të ketë lidhur kontratë të vlefshme, me një operator menaxhues të strukturave akomoduese me 4 ose 5 yje, i cili është mbajtes i një marke tregtare të rregjistruar dhe të njohur ndërkombëtarisht “brand name”.

### **Dokumentacioni i aplikimit për pajisjen me certifikatë klasifikimi**

1. Dokumentacioni që duhet të paraqesë subjekti:

- a) Kërkesë për t’u pajisur me certifikatë klasifikimi, sipas modelit bashkëlidhur urdhrit;
- b) Formularin e vetdeklarimit;
- c) Akti i pronësisë ose përdorimit të strukturës;
- ç) Vërtetim për regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit si person fizik/juridik me objekt veprimtarie si strukturë akomoduese;
- d) Planimetrinë e strukturës akomoduese;
- dh) Akti i kolaudimit të strukturës akomoduese;
- e) Vërtetimin që struktura plotëson kushtet për masat e mbrojtjes nga zjarri lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi;
- ë) Vërtetimin që struktura plotëson kushtet higjieno sanitare, lëshuar nga Instituti i Shëndetit Publik;
- f) Foto të brendshme dhe të jashtme të objektit;

- g) Kontrata e lidhur me operatorin e strukturave akomoduese me 4 ose 5 yje, i cili është mbajtes i një marke tregtare të regjistruar dhe të njohur ndërkombëtarisht “brand name”.
- gj) Vërtetim i gjendjes gjyqësore të pronarit/administratorit;
- h) Vërtetimin e pagesës së tarifës së aplikimit dhe verifikimit për pajisjen me certifikatë klasifikimi.

### **Procedura e aplikimit**

1. Procedura e klasifikimit të strukturave akomoduese me 4 ose 5 yje i nënshtrohet tre fazave:

- a) Faza e parë përfshin procesin e vetëdeklarimit të sipërmarrësit turistik, i cili konsiston në plotësimin e formularit të vetdeklarimit dhe dorëzimit të dokumentacionit përkatës të parashikuar në nenin 5 të urdhrit nr.243 datë 09.07.2019 “Për miratimin e rregullores mbi procedurën e klasifikimit të strukturave akomoduese”.
- b) Faza e dytë përfshin verifikimin në terren të të dhënave të vetëdeklarimit dhe përgatitjen e raportit të verifikimit, nga grupi i punës i ngritur me urdhër ministri.
- c) Faza e tretë përfshin shqyrtimin e dokumentacionit dhe raportit të verifikimit, nga Komisioni i Standardizimit të Veprimtarive Turistike.

### **Procedura e shqyrtimit të dokumentacionit për klasifikimin e strukturave akomoduese**

1. Komisioni i Standardizimit brenda 60 ditëve nga data e depozitimit të kërkesës, formularit të vetdeklarimit, dokumentacionit të parashikuar në nenin 5 të urdhrit dhe pas hartimit të raportit të verifikimit, shqyrton dhe vlerëson dokumentet dhe të dhënat për përmbushjen e kriterëve të kërkuara për klasifikimin e strukturës akomoduese.
2. Pas depozitimit të kërkesës nga ana e subjektit Komisioni i Standardizimit, brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të kërkesës, njofton grupin e punës të ngritur me urdhër ministri, për verifikimin në terren të përmbushjes së kriterëve sipas parashikimeve të VKM-së nr.730, datë 20.10. 2016 “Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifën, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave akomoduese”, i ndryshuar.
3. Procesi i verifikimit në terren të përmbushjes së kriterëve nga sipërmarrësi turistik duhet të përfundojë brenda 20 ditëve nga data e njoftimit të Komisionit të Standardizimit.
4. Në përfundim të procesit të verifikimit, grupi i punës harton një raport përmbledhës për verifikimet e kryera dhe ia dorëzon Komisionit të Standardizimit brenda 5 ditëve nga data e përfundimit të procesit të verifikimit.
5. Në përfundim të procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit Komisioni, sipas rastit merr vendim dhe ia përcjell Ministrit për miratim për:
  - a) lëshimin e certifikatës së klasifikimit e cila përcakton nivelin përkatës të strukturës akomoduese nëse është më 4 apo 5 yje.
  - b) refuzimin e kërkesës për certifikatë klasifikimi

6. Në çdo rast vendimi i Komisionit të Standardizimit duhet të jetë i arsyetuar dhe të përmbajë kriteret e përmbushura nga struktura akomoduese, si dhe kategorinë e nivelin e përcaktuar për këtë strukturë.

7. Në rast të refuzimit të kërkesës për lëshimin e certifikatës së klasifikimit, kërkuesi ka të drejtë të paraqesë kërkesën e tij për ta nisur procesin përsëri vetëm pasi të kenë kaluar 90 ditë nga refuzimi, dhe do të trajtohet si kërkesë e paraqitur për herë të parë.

Komisioni, brenda 10 ditëve nga data e marrjes së miratimit nga Ministri për përcaktimin e nivelit të klasifikimit, njofton aplikuesin për miratimin e certifikatës së klasifikimit.